

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

**Pasqyrat Financiare
në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Përmbajtja

	<u>Faqja</u>
Raporti i audituesve të pavarur	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare	5-40



RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin dhe Drejtimin e Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k.

Raport për auditimin e pasqyrave financiare

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, si dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe të ndryshimeve në kapital dhe të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar Auditimit (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Coca-Cola Bottling Shqipëria sh.p.k. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, u audituan nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion të pakualifikuar për ato pasqyra në 7 Prill, 2020.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi dhe personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizem profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencën e auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është me i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetedijshme e gjithë informacionit, keq përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Coca-Cola Bottling Shqipëria Sh.p.k., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin e Drejtimit të Shoqërisë për vitin 2020, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohuritë që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse kanë gabime materiale.

Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors
30 Mars 2021
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë në lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënimi	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Aktivitet			
Aktive afatgjata materiale	5	1,358,992,115	1,304,579,419
Aktive me të drejtë përdorimi	6	182,538,231	75,206,490
Investime në tituj kapitali	7	23,000,000	23,000,000
Huadhënie	8	366,152,000	243,540,000
Totali i aktiveve afatgjata		1,930,682,346	1,646,325,909
Inventarët	9	279,208,644	293,793,769
Llogari të arkëtueshme tregtare	10	4,397,643	11,255,416
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	11	34,750,319	22,549,824
Tatim fitimi i parapaguar	26	15,397,492	-
Aktive të tjera	12	38,951,850	66,492,326
Depozita me afat	13	282,348,000	395,310,000
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	14	496,558,050	435,313,267
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,151,611,998	1,224,714,602
Totali i aktiveve		3,082,294,344	2,871,040,511
Detyrimet dhe kapitali			
Kapitali i paguar	15	1,493,040,000	1,493,040,000
Rezerva ligjore	16	29,987,807	29,987,807
Rezerva të tjera	17	210,886,113	41,264,800
Fitim i mbartur		577,348,117	678,485,253
Totali i kapitalit		2,311,262,037	2,242,777,860
Detyrimet e qirasë – afatgjata	6	115,882,952	23,486,722
Detyrime tatimore të shtyra	26	28,585,383	24,791,335
Totali i detyrimeve afatgjata		144,468,335	48,278,057
Detyrimet e qirasë- afatshkurtra	6	57,683,469	40,913,209
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	18	5,183,846	8,784,416
Llogari të pagueshme tregtare	19	387,568,463	308,175,446
Tatim fitimi i pagueshëm		-	18,177,041
Detyrime të tjera	20	176,128,194	203,934,482
Totali i detyrimeve afatshkurtra		626,563,972	579,984,594
Totali i detyrimeve		771,032,307	628,262,651
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		3,082,294,344	2,871,040,511

Shënimet, në faqet 5 deri 40, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020



(Shumat në lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor:		
	2020	2019	
Të ardhurat nga kontratat me klientët	21	3,533,079,652	3,962,641,964
Kosto e mallrave të shitura	23	(2,149,275,227)	(2,390,477,920)
Fitimi bruto		1,383,804,425	1,572,164,044
Të ardhura të tjera	22	204,041,276	262,158,857
Kosto të shpërndarjes	23	(591,466,896)	(701,781,733)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	23	(326,367,557)	(308,972,730)
Humbje të tjera, neto	24	(7,289,911)	(19,658,090)
		(721,083,088)	(768,253,696)
Fitimi operativ		662,721,337	803,910,348
Të ardhura financiare	25	75,268,558	31,970,073
Shpenzime financiare	25	(55,768,702)	(33,705,531)
Të ardhura financiare (humbje), neto		19,499,856	(1,735,458)
Fitimi para tatimit		682,221,193	802,174,890
Tatimi mbi fitimin	26	(104,873,076)	(123,689,637)
Fitimi i vitit		577,348,117	678,485,253
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		577,348,117	678,485,253

Shënimet, në faqet 5 deri 40, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare të Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K. janë aprovuar më datë 16 mars 2021 nga Bordi i Drejtorëve dhe u firmosën në emër të tyre nga drejtimi i Shoqërisë më 30 mars 2021 nga:


Ervina Kuta
Drejtor i Financës dhe Administratës



Luca Busi
President

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali i paguar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 1 Januar 2019	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	486,763,484	2,051,056,091
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse					
Fitimi i vitit	-	-	-	678,485,253	678,485,253
Të ardhura gjithëpërfshirëse të tjera për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	678,485,253	678,485,253
Shpërndarje dividend (shënimi 15)	-	-	-	(486,763,484)	(486,763,484)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	678,485,253	2,242,777,860
Gjendja më 1 janar 2020	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	678,485,253	2,242,777,860
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse					
Fitimi i vitit	-	-	-	577,348,117	577,348,117
Të ardhura gjithëpërfshirëse të tjera për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	577,348,117	577,348,117
Rezerva të tjera (shënimi 17)	-	-	169,621,313	(169,621,313)	-
Shpërndarje dividend (shënimi 15)	-	-	-	(508,863,940)	(508,863,940)
Gjendja më 31 dhjetor 2020	1,493,040,000	29,987,807	210,886,113	577,348,117	2,311,262,037

Shënimet në faqet 5 deri 40, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënimi	2020	2019
Flukse monetare nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit:		577,348,117	678,485,253
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin	5,6	236,554,713	213,581,570
Humbje neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	24	3,646,133	19,314,397
Zhvlerësimi i inventarëve	23	47,003,971	79,112,009
Fshirje të llogarive të arkëtueshme	10	2,013,712	-
Fshirje të llogarive të pagueshme	20	(11,085,079)	-
Të ardhura nga interes	25	(12,244,901)	(7,747,681)
Të ardhura nga dividendët	25	(2,447,280)	(1,692,043)
Shpenzime interesi qiraje		5,141,913	2,649,452
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	104,873,076	123,689,638
		950,804,375	1,107,392,595
<i>Ndryshime në:</i>			
Inventarë	9	(32,418,846)	(164,852,679)
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	11	(12,200,495)	34,454,314
Aktive të tjera	12	31,924,253	(3,559,192)
Llogari të arkëtueshme tregtare	10	4,844,061	13,152,034
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	18	(3,600,570)	(5,467,275)
Llogari të pagueshme tregtare	19	70,604,474	77,942,423
Detyrime të tjera	20	(27,806,288)	41,306,291
Mjete monetare nga aktivitetet operative		982,150,964	1,100,368,511
Interesa të arkëtuar		7,861,124	3,060,189
Interesa të paguar për qira		(5,141,913)	(2,649,452)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(134,653,560)	(115,874,927)
Mjete monetare neto nga aktivitetet operative		850,216,615	984,904,321
Mjete monetare nga veprimtaritë investuese			
Depozita me afat	13	112,962,000	62,906,840
Dividend të arkëtuar	7	2,447,280	1,692,043
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	5	(197,795,882)	(168,551,737)
Të ardhura nga shitjet e aktiveve afatgjata materiale	5	1,198,152	2,910,096
Huadhënie	8	(122,612,000)	(58,410,000)
Mjete monetare neto nga veprimtaritë investuese		(203,800,450)	(159,452,758)
Mjete monetare nga veprimtaritë e financimit			
Pagesa për detyrimet e qirasë	6	(76,307,442)	(79,538,077)
Dividend të paguar	15	(508,863,940)	(486,763,484)
Mjete monetare neto nga aktivitetet financuese		(585,171,382)	(566,301,561)
Rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre		61,244,783	259,150,002
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 1 janar	14	435,313,267	176,163,265
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor	14	496,558,050	435,313,267

Shënimet në faqet 5 deri 40 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. Njësia raportuese

Coca-Cola Bottling Shqipëria SH.P.K. ("Shoqëria") është themeluar në qershor të 1993, si një shoqëri me kapital të përbashkët ndërmjet Aziende Commerciali Industriali e Servizi S.r.l. ("ACIES"), e cila është një shoqëri italiane me zyrat qendrore në Bolonja, Itali; The Coca-Cola Export Corporation ("TCCEC"), e themeluar në shtetin e Delaware, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe Invest P.F., një shoqëri shqiptare me kapital shtetëror me zyrat qendrore në Tiranë, Shqipëri dhe themeluar në Shqipëri si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria është angazhuar në prodhimin, mbushjen dhe shitjen e të gjitha produkteve të markës Coca-Cola në Shqipëri, sipas kontratës së Shoqërisë me The Coca-Cola Company (TCCC) dhe The Coca-Cola Export Corporation.

Ortakët e shoqërisë dhe pjesëmarrjet e tyre në kapital janë si më poshtë:

Ortakët	Në %	
	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
SIBEG Srl	74.69	74.69
TCCEC	22.65	22.65
INVEST P.F.	2.66	2.66
	100.00	100.00

Gjatë vitit 2020 nuk ka patur ndryshime në kapitalin e Shoqërisë dhe në kuotat respektive të ortakëve.

Shoqëria është vendosur në Kashar, 5 km nga Tiranë (Shqipëri) me 344 punonjës me 31 dhjetor 2020 përfshirë punonjesit sezonal (2019: 346 punonjes).

2. Politika të rëndësishme kontabël

Bazat e përgatitjes: Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") duke u bazuar në kostot historike, përveç instrumenteve të kapitalit të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ").

Politikat kryesore të kontabilitetit të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të rëndësishme kontabël. Kjo gjithashtu kërkon që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Zërat që kanë nevojë për gjykim të veçantë dhe kompleks si dhe zëra ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpjeguar në Shënimin 3.

Parimi i vijimësisë: Për periudhën ushtrimore që përfundon në vitin 2021, Shoqëria nuk pret që të ketë devijime nga shifrat e buxhetuara për shkak të situatës pandemike, e cila megjithatë nuk është e mundur të matet në mënyrë të besueshme dhe plotësisht në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare. Megjithatë, drejtimi i Shoqërisë beson në vijimësinë e rezultateve pozitive.

Drejtimi i Shoqërisë ka bërë një vlerësim të aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e përmendur më lart dhe është besimplote se Shoqëria zotëron burime financiare të mjaftueshme për të vazhduar veprimtarinë e saj për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare vazhdojnë të përgatiten mbi parimin e vijimësisë.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Përkthimi i monedhave të huaja. Monedha funksionale e Shoqërisë është monedha e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin vepron njësitë ekonomike. Monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha e saj e prezantimit, është monedha kombëtare e Republikës së Shqipërisë ("Lek").

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datat e transaksioneve.

Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj janë përkthyer në monedhën funksionale të Shoqërisë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë ("BSH") në datën e raportimit. Humbjet dhe fitimet nga këmbimi valutor që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të Shoqërisë me kursin zyrtar të këmbimit në fundvit sipas BSH, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, si të ardhura financiare ose shpenzime financiare.

Humbjet dhe fitimet e kursit të këmbimit që kanë të bëjnë me huamarrjet dhe mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse brenda 'të ardhurave financiare ose shpenzimeve financiare'. Të gjitha fitimet dhe humbjet e tjera të këmbimit valutor paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në 'Fitim / (humbje) të tjera, neto'. Përkthimi me kursin e fund vitit nuk zbatohet për zërat jo-monetarë që maten me kosto historike.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja që maten me vlerën e drejtë, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj janë regjistruar si pjesë e fitimit dhe humbjes nga vlera e drejtë.

Aktivitet Afatgjata Materiale: aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto, minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin, kur është e nevojshme. Aktivitet afatgjata materiale përfshijnë aktivitet në proces për përdorim të ardhshëm si aktiv afatgjatë material.

Shpenzimet e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivitet ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas nevojës, vetëm kur kemi siguri që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin do të rrjedhin në shoqëri dhe kosto e aktivitet mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtjes ditore njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve të mëdha apo komponentë të aktiveve afatgjata materiale kapitalizohen dhe pjesa e zëvendësuar ç'regjistrohet.

Në fund të secilës periudhë raportuese drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim të aktiveve afatgjata materiale. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivitet minus kostot e ç'regjistrimit dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin, në masën që tejkalon tepriçën e rivlerësimit të mëparshëm në kapitalin e vet. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktivitet në vitet e mëparshme anulohet kur konsiderohet e përshtatshme dhe nëse ka patur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivitet në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimi.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrjet jashtë përdorimi përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël dhe njihen në fitim ose humbje për vitin në 'fitime / (humbje) të tjera, neto'.

Amortizimi: Toka dhe aktivitet në proces nuk amortizohen. Jeta e dobishme e tokës së marrë në përdorim është 99 vjet dhe amortizohet me 1.01% duke përdorur metodën lineare. Amortizimi për zërat e tjerë të aktiveve afatgjata materiale llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur duke shpërndarë koston dhe vlerën e mbetur të tyre sipas jetëgjatësisë së dobishme:

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Amortizimi (vazhdim):

E drejta e përdorimit të tokës	1.01%
Ndërtesa dhe instalime	2.5%
Makineri dhe pajisje	20%
Automjete	20%
Ambalazhe të rikthyeshme dhe frigoriferë	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	20 25%

Vlera e mbetur e një aktivi është shuma e vlerësuar që Shoqëria do të përfitojë nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivit minus kostot e vlerësuara për ta nxjerrë jashtë përdorimit, në qoftë se aktivi është tashmë në moshën dhe në kushtet e pritshme në fund të jetës së tij të dobishme. Vlera e mbetur e aktivit dhe jeta e dobishme rishikohen, dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe raportimi.

Aktivitet me të drejtë përdorimi: Shoqëria merr me qira ndërtesat, fasadat dhe automjetet.

Kontratat mund të përmbajnë komponentë qiraje dhe jo-qiraje. Shoqëria e ndan vlerësimin në kontratë për komponentët e qirasë dhe jo-qirasë bazuar në çmimet e tyre të pavarura relative. Sidoqoftë, për qiratë e automjeteve për të cilat Shoqëria është qiramarrëse, ajo ka zgjedhur të mos ndajë komponentët e qirasë dhe të jo-qirasë, por i llogarit këto si një komponent të vetëm të qirasë. Komponentët e jo-qirasë së kontratave të automjeteve konsistojnë në kostot e shërbimeve të rregullta mujore të përfshira në këstet mujore të kontraktuara. Shoqëria njeh aktivitet me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (d.m.th., data kur aktivi është i disponueshëm për përdorim).

Aktivitet me të drejtë përdorimi maten me kosto, minus çdo zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, dhe rregullohen për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë.

Kosto e aktiveve me të drejtë përdorimi përfshin:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë e kryer në ose para datës së fillimit të qirasë, pa përfshirë çdo incitivë të përfituar,
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për kthimin e aktivit në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë.

Aktivitet me të drejtë përdorimi amortizohen me vlerën më të vogël mes jetës së dobishme të aktivit dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Nëse Shoqëria është e sigurt për të ushtruar një mundësi blerjeje, aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet për jetën e dobishme të aktiveve kryesore. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi që lidhen me ndërtesat, fasadën dhe automjetet llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë afatit të përcaktuar të qirasë.

Ndërtesa
Fasada
Automjete

Jeta e dobishme në vite

[5]
[3]
[1 deri në 5]

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare. Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka tregues që një aktiv mund të zhvlerësohet. Nëse ekziston ndonjë tregues, ose kur kërkohet prova vjetore për matjen e zhvlerësimit, Shoqëria vlerëson vlerën e rikuperueshme të aktivitetit, me qëllim përcaktimin e masës së humbjes (nëse ka të tillë). Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontothen rrjedhat e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit. Për të përcaktuar vlerën e drejtë minus koston e nxjerrjes jashtë përdorimit, merren parasysh transaksionet e tregut të kryera së fundmi. Nëse transaksione të tilla nuk mund të gjenden, përdoret një model i përshtatshëm vlerësimi. Për qëllime të testimit të rënies në vlerë, aktivitet grupohen së bashku në grupin më të vogël të tyre i cili gjeneron rrjedha parash nga përdorimi i vazhdueshëm i tyre dhe që janë të pavarura nga rrjedhat e parasë të aktiveve ose grupeve të tjera të aktiveve (“njësia gjeneruese e parasë”).

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. Humbjet nga rënia në vlerë, që janë njohur në periudhat e mëparshme, vlerësohen në çdo datë raportimi nëse ka evidencë që humbja është ulur ose nuk ekziston më. Humbja nga rënia në vlerë çregjistrohet nëse ka patur ndryshime në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë çregjistrohet në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e tij kontabël neto nga zhvlerësimi ose amortizimi që do të ishte përcaktuar, nëse nuk do të ishte njohur humbje nga rënia në vlerë.

Detyrimet e qirasë: Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që duhen bërë gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë:

- pagesat fikse (përfshirë pagesat fikse në-thelb), minus çdo stimul qiraje të marrë,
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit,
- shumat e pritshme për t'u paguar nga qiramarrësi sipas vlerës së mbetur të garancive,
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, dhe
- pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë reflekton ushtrimin nga qiramarrësi të një opsioni për përfundimin e qirasë.

Pagesat e qirasë skontothen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë përdoret norma rritëse e huamarrjes së Shoqërisë, që është norma e interesit që Shoqëria do të duhet të paguante për të marrë hua fondet e nevojshme për të siguruar një aktiv të së njëjtës vlerë me aktivin me të drejtë përdorimi në një mjedis ekonomik të ngjashëm, me të njëjtat terma, kolateral dhe kushte.

Për të përcaktuar normën rritëse të huamarrjes, Shoqëria përdor normat e interesit të financimit bankar të nivelit të dytë duke marrë parasysh termin, vendin, monedhën dhe kolateralin.

Pas datës së fillimit, shumat e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar interesin e maturuar në detyrimin e qirasë dhe zvogëlohet për pagesat e kryera të qirasë.

Për më tepër, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri matet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar të tilla pagesa të qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë aktivin bazë.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Pagesat e qirasë alokohen midis pagesave fikse dhe interesit në detyrimin e qirasë. Interesat në detyrimin e qirasë ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike interesi për tepricën e mbetur të detyrimit të qirasë për secilën periudhë.

Pagesat që lidhen me qira afatshkurtra të automjeteve dhe të gjitha qiratë e aktiveve me të drejtë përdorimi me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si një shpenzim në pasqyrën e fitimeve ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qira me afat prej 12 muajsh ose më pak. Aktivet me vlerë të ulët janë aktive me një vlerë prej 5,000 Euro ose më pak.

Përcaktimi i afatit të qirasë së kontratave me mundësi rinovimi dhe përfundimi

Shoqëria përcakton afatin e qirasë si periudhën e paanullueshme të qirasë, së bashku me çdo periudhë të mbuluar nga një opsion për të zgatur qiranë nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion, ose ndonjë periudhë e mbuluar nga një opsion për të përfunduar qiranë, nëse Shoqëria ka siguri të arsyeshme për të mos ushtruar atë opsion.

Shoqëria ka disa kontrata qiraje që përfshijnë mundësi zgjatjeje të afatit dhe përfundim të kontratës. Shoqëria zbaton gjykimin në vlerësimin nëse ka siguri të arsyeshme që të ushtrojë opsionin për të rinovuar ose përfunduar qiranë. Kjo do të thotë që merr në konsideratë të gjithë faktet dhe rrethanat që krijojnë nxitës ekonomikë për Shoqërinë që të ushtrojë opsionin për zgjatjen e qirasë, ose për përfundimin e qirasë. Pas datës së fillimit, Shoqëria rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim të rrethanave të cilat janë brenda kontrollit të saj dhe ndikojnë në aftësinë e saj për të ushtruar ose jo mundësinë e rinovimit ose përfundimit.

Qira operative: Kur Shoqëria është një qiradhënës në një qira e cila nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që vijnë nga pronësia tek qiramarrësi (p.sh. qiraja operative), pagesat e qirasë nga qiratë operative njihen si të ardhura të tjera mbi një bazë lineare.

Instrumentet financiare: një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një detyrim financiar ose një instrument kapitali të një njësie ekonomike tjetër.

Aktivët financiarë – njohja fillestare: Aktivët financiarë klasifikohen, në njohjen fillestare, siç maten dhe më pas me koston e amortizuar, vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) dhe vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat kontraktuale të flukeve monetare dhe modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Me përjashtim të llogarive të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një komponent financiar të rëndësishëm ose për të cilat Shoqëria ka përdorur mjete praktike, Shoqëria fillimisht mat një aktiv financiar me vlerën e tij të drejtë plus, në rastin e një aktivi financiar ose detyrimi financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, koston e transaksionit. Të arkëtueshmet tregtare që nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi ose për të cilin Shoqëria ka aplikuar mjete praktike, maten me çmimin e transaksionit të përcaktuar në SNRF 15.

Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ai duhet të krijojë flukse monetare që janë 'vetëm pagesa të principalit dhe të interesit (VPPI)' mbi shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim referohet si testi VPPI dhe kryhet në një nivel instrumenti. Aktivët financiarë me flukse parash që nuk janë VPPI klasifikohen dhe maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, pavarësisht nga modeli i biznesit.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si ajo administron aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse parash. Modeli i biznesit përcakton nëse flukset e parave do të rezultojnë nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, shitja e aktiveve financiare ose të dyja. Aktivet financiare të klasifikuara dhe të matura me koston e amortizuar mbahen brenda një modeli biznesi me qëllim të mbledhjes së flukse monetare kontraktuale ndërsa aktivet financiare të klasifikuara dhe të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse mbahen brenda një modeli biznesi me objektivat e mbajtjes për të mbledhur flukse monetare kontraktuale si edhe të shitjes.

Blerjet ose shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda një afati kohor të vendosur nga rregullorja ose konventa në treg (tregtia sipas mënyrës së rregullt) njihen në datën e tregtimit, d.m.th., datën që Shoqëria zotohet të blejë ose shesë aktivin.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare:

Për qëllime të matjes pasuese, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumenta borxhi)
- Aktive financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit)
- Aktive financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pa riciklim të fitimeve dhe humbjeve kumulative gjatë ç' regjistrimit (instrumentat e kapitalit)
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Shoqëria mban aktive financiare të kategorisë së parë dhe të tretë, të cilat janë përmbledhur në detaje më poshtë.

Aktive financiare me kosto të amortizuar (instrumente borxhi)

Aktivtë financiare me kosto të amortizuar më pas maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (IRE) dhe janë subjekt i zhvlerësimit. Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi ç' regjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivtë financiare të Shoqërisë me kosto të amortizuar përfshijnë llogaritë e arkëtueshmet tregtare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, depozitat me afat të shkurtër dhe një hua për një palë të lidhur.

Aktivtë financiare të përcaktuara me vlerën e drejtë përmes VDATGJ (instrumentet e kapitalit)

Pas njohjes fillestare, Shoqëria mund të zgjedhë të klasifikojë investimet e saj të kapitalit neto si instrumente të kapitalit të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes VDATGJ kur ato plotësojnë përkufizimin e kapitalit neto sipas SNK 32 Instrumentet Financiarë: Paraqitja dhe nuk mbahen për tregtim. Klasifikimi përcaktohet në një nivel instrumenti individual.

Fitimet dhe humbjet nga këto aktive financiare nuk paraqiten kurrë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Dividendët njihen si të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur përcaktohet e drejta Shoqërisë për të marrë pagesën, përveç rastit kur Shoqëria përfiton nga të ardhurat e tilla si rikuperim i një pjese të koston së aktivitetit financiar, në këtë rast, fitimet të tilla njihen përmes VDATGJ.

Instrumentet e kapitalit neto të përcaktuar me vlerën e drejtë përmes VDATGJ nuk i nënshtrohen zhvlerësimit. Shoqëria zgjedhi të klasifikojë investimet e saj në kapital nën këtë kategori.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Zhvlerësimi i Aktiveve Financiare: Shoqëria njih një provizion për humbjet e pritshme (HP) për të gjithë instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. HP bazohet në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale që janë për t'u paguar nga Shoqëria, në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukseve të mjeteve monetare që Shoqëria pret të marrë, të skontuara me një përfrim të normës origjinale të interesit efektiv. HP njihen në dy faza. Për ekspozimet e kredisë për të cilat nuk ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare, HPK përfaqëson humbjet e parashikuara të kredisë që rezultojnë nga ngjarje të mospagesës për një instrument financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit (HP 12-mujore). Nëse rreziku i kredisë së instrumentit financiar është shtuar ndjeshëm që nga njohja e tij fillestare, shoqëria do të masë provizionin për humbjen e instrumentit financiar në atë shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë përgjatë gjithë jetës së tij (HP për gjithë jetën).

Për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe aktivet kontraktuale, Shoqëria zbaton një përjasje të thjeshtuar në llogaritjen e HP. Shoqëria nuk gjurmon ndryshimet në rrezikun e kredisë, por përkundrazi njih një provizion të humbjes bazuar në HP për gjithë jetën në secilën datë të raportimit. Shoqëria ka krijuar një matricë provizionit që bazohet në përvojën e saj historike të humbjes së kredisë, e rregulluar për faktorët e ardhshëm specifik për debitorët dhe mjedisin ekonomik.

Aktivët financiarë -fshirja: Aktivët financiarë fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka bërë të gjitha përpjekjet praktike për arkëtimin e tyre dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për arkëtim. Fshirja përfaqëson një ngjarje të ç' regjistrimit. Shoqëria mund të fshijë aktivët financiarë që ende i nënshtrohen veprimtarisë së mbledhjes me forcë kur Shoqëria kërkon të rimarrë shumat të cilat sipas kontratës janë të arkëtueshme, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për arkëtim.

Aktivët financiarë - ç' regjistrimi. Shoqëria i ç' regjistron aktivët financiarë kur (a) aktivët janë shlyer ose të drejtat për të marrë flukse monetare nga aktivi kanë skaduar ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat e saj për të arkëtuar flukse monetare nga aktivi financiar ose ka ka hyrë në një marrëveshjeje të kalimit kualifikues, ndërkohë që (i) gjithashtu ka transferuar në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, ose (ii) nuk ka transferuar as nuk ka mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Kontrolli mbahet nëse pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin ndaj një pale të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë në shitje.

Detyrimet financiare –njohja fillestare: Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, si detyrime financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, hua dhe huamarrje, pagesa të pagueshme, ose si derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive, siç është e përshtatshme.

Të gjitha detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe, në rastin e kredive dhe huamarrjeve dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt.

Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e pagueshme tregtare dhe të pagueshme të tjera .

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes
- Detyrimet financiare me kosto të amortizuar (kredi dhe huamarrje)

Shoqëria nuk mban asnjë detyrim financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes.

Detyrimet financiare – ç' regjistrimi: Detyrimet financiare ç' regjistrohen kur detyrimi i specifikuar në kontratë është përmbushur ose i ka kaluar afati.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Kompensimi i instrumentave financiarë: Aktivët dhe detyrimet financiarë kompensohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e ligjshme për të kompensuar shumat e njohura dhe ka si qëllim ose shlyerjen në bazë neto, ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë kompensimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë e ligjshme në të gjitha rrethanat në vijim (i) në rrjedhën normale të biznesit (ii) në rastet e dështimit dhe (iii) në rastet e paaftësisë paguese ose falimentimit.

Tatimi mbi fitimin: Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe të mëparshme. Normat tatimore dhe ligjet tatimore të përdorura për të llogaritur vlerën e tatimit mbi fitimin janë në përputhje me legjislacionin e miratuar ose të nxjerrë në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese në vendet ku shoqëria operon dhe gjeneron të ardhura të tatueshme.

Taksa e tatimit mbi të ardhurat përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse kjo është njohur në kapitalin neto ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen, në të njëjtën periudhë ose në një periudhë tjetër, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose direkt në kapital.

Drejtimi vlerëson në mënyrë periodike pozicionet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e zbatueshme tatimore i nënshtrohen interpretimit dhe vendos dispozitat kur është e përshtatshme.

Tatimi i shtyrë: përlllogaritet mbi diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar në datën e raportimit. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktiviteti ose një detyrimi në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi, apo nëse në kohën e transaksionit, nuk ndikonte as në fitimin kontabël dhe as në fitimin e tatueshëm.

Vlera kontabël e një aktiviteti tatimor të shtyrë do të rishikohet në çdo datë të periudhës raportuese dhe do të zvogëlohet deri në masën që nuk është e mundur që të jetë i disponueshëm fitim i tatueshëm i mjaftueshëm për të lejuar përdorimin e një pjese ose të gjithë atij aktiviteti tatimor të shtyrë.

Aktivitetet e tatimeve të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është bërë e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme do të lejojnë rikuperimin e aktivitetit tatimor të shtyrë.

Balancat tatimore të shtyra maten me normat e tatimit të miratuara ose të vendosura substancialisht në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore e mbartur.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar aktivitetet tatimore kundrejt detyrimeve tatimore dhe kur aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra lidhen me tatimin mbi të ardhurat të përcaktuara nga i njëjti autoritet tatimor dhe ka një qëllim për të shlyer balancat mbi baza neto.

Pozicionet e pasigurta tatimore: Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishqyrtohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojnë në vendosjen e taksave shtesë nëse këto pozicione do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose miratohen në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese, si dhe vendime të njohura nga gjykatat mbi çështje të tilla. Detyrimet për penalitetet, interesat dhe detyrimet tatimore të ndryshme nga tatimi mbi fitimin, njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit mbi shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për pozicionet e pasigurta të tatimit mbi fitimin, përveç interesave dhe gjobave, regjistrohen brenda tatimit mbi fitimin. Rregullimet për pozicionet e pasigurta të tatimit mbi fitimin në lidhje me interesat dhe gjobat, regjistrohen neto brenda shpenzimeve financiare dhe fitim/(humbjeve) të tjera, përkatësisht.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Tatimi mbi vlerën e shtuar. Tatimi mbi vlerën e shtuar që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore në momentin më të hershëm ndërmjet, (a) arkëtimit të llogarive të arkëtueshme nga klientët ose (b) lëvrimit të mallrave ose shërbimeve tek klientët. TVSH-ja në blerje në përgjithësi mund të rikuperohet kundrejt TVSH-së së shitjeve pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe jepet si informacion shpjegues veçmas si një aktiv dhe detyrim. Aty ku është bërë një provigjion për HP të të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

Kompensimi: Shoqëria nuk kompenson aktivet dhe detyrimet ose të ardhurat dhe shpenzimet, përveç nëse kërkohet ose lejohet nga një SNRF. Për më tepër, Shoqëria paraqet në bazë neto fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup transaksionesh të ngjashme, për shembull, fitime dhe humbje në valutë të huaj. Sidoqoftë, Shoqëria paraqet fitime dhe humbje të tilla veçmas nëse ato janë materiale.

Përcaktimi i vlerës së drejtë: Një numër i politikave kontabël të shoqërisë dhe shënimeve shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare.

Drejtimi i Shoqërisë vlerësoi se vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalentët të tyre, llogarive të arkëtueshmet tregtare, depozitat me afat, llogaritë e pagueshme tregtare, aktivet dhe detyrimet e tjera afatshkurtra përafrojnë vlerën e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimeve afatshkurtra të këtyre instrumenteve.

Vlera e drejtë e investimeve në kapital është vlerësuar duke përdorur modelin e flukseve monetare të skontuara.

Një vlerësim i tillë kërkon që drejtimi të bëjë supozime të caktuara në lidhje me inputet e modelit, përfshirë flukset monetare të parashikuara, normën e skontimit, rrezikun e kredisë dhe paqëndrueshmërinë. Probabiliteti i vlerësimeve të ndryshme brenda intervalit mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme dhe të përdoret në vlerësimin e vlerës së drejtë të drejtimit për investimin e kapitalit.

Parapagimet. Parapagimet mbahen me kosto minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet të cilat lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti, ose kur parapagimi lidhet me një aktiv, i cili do të klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël të aktivitetit pasi Shoqëria të ketë marrë kontrollin e aktivitetit dhe pritet që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin. Parapagimet e tjera pakësohen në fitim ose humbje kur merren shërbimet e lidhura me parapagimet. Nëse ekziston një tregues se aktivet, mallrat ose shërbimet në lidhje me një parapagim nuk do të merren, vlera kontabël e parapagimit zhvlerësohet në përputhje me rrethanat dhe humbja përkatëse nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

Dividendët. Dividentët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe përpara se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, shpalolet në shënimet e ngjarjeve të mëvonshme.

Inventarët. Inventarët regjistrohen me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e koston first-in, first-out. Në rastin e inventarëve të prodhuar apo prodhimit në proces, në kosto përfshihet pjesa e shpenzimeve të përgjithëshme në bazë të kapacitetit normal operativ.

Kostot e bëra për sjelljen e çdo produkti në vendin dhe gjendjen e tij aktuale llogariten, si më poshtë:

- Materialet e para: kostoja e blerjes në parimin first-in, first-out
- Produktet e gatshme dhe puna në proces: kostoja e materialeve direkte, kostoja e punës dhe shpenzimet përkatëse të prodhimit bazuar në kapacitetin normal të funksionimit.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Përfitimet e punonjësve: Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore-Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit. kryen pagesa për llogari të vetë dhe të punonjësve për të kontribuar në fondet e detyrueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Këto kosto njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin

Sigurimi shëndetësor i punonjësve - Shoqëria gjithashtu ka zbatuar një plan të sigurimit shëndetësor të punonjësve. Kontributi i paguhet një kompanie sigurimesh në përpjesëtim me kohën e punësimit të punonjësit në Shoqëri dhe regjistrohet si një shpenzim nën 'Shpenzimet e Personelit'. Shoqëria bën pagesa fikse për çdo punonjës në bazë vjetore dhe nuk ka ndonjë detyrim tjetër ndaj planit të sigurimit shëndetësor në fund të vitit.

Provizionet. Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, është e mundur që të nevojiten flukse dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme që pritet të ndodhin me një normë para tatimit që tregojnë vlerësimet aktuale të tregut mbi vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet e lidhura me detyrimin. Provizionet shqyrtohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që do të kërkohet një fluks dalës i burimeve që përbëjnë përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Provizionet nuk njihen në humbjet e ardhshme operative.

Njohja e të ardhurave: Shoqëria ushtron veprimtarinë e prodhimit, distribucionit dhe shitjes së pijeve të gazuara dhe jo-alkolike përmes shpërndarjes së madhe dhe zinxhirëve modernë të tregtisë.

Të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur kontrolli i mallrave ose shërbimeve i transferohen klientit në një shumë që reflekton shumën korresponduese për të cilën Shoqëria pret të ketë si të drejtë në këmbim për këto mallra ose shërbime. Të ardhurat njihen neto nga zbritjet, taksat e vlerës së shtuar, detyrimet e eksportit, akciza, pagesa të tjera të detyrueshme të ngjashme. Shoqëria në përgjithësi ka konkluduar se po vepron si njësi kryesore në marrëveshjet e saj të të ardhurave, duke pasur kontrollin e plotë mbi mallrat ose shërbimet përpara se t'i transferojë ato tek klienti.

Shitja e mallrave. Të ardhurat nga shitja e produkteve të gatshme dhe mallrave njihen në një moment kohor të caktuar kur kontrolli mbi mallin është transferuar, në momentin kur mallrat janë dorëzuar tek klienti, i cili ka liri të plotë mbi mallrat dhe nuk ka detyrim të paplotësuar që mund të ndikojë në pranimin e mallrave. Dorëzimi ndodh kur mallrat janë dërguar në vendndodhjen specifike, rreziqet e dëmtimit dhe humbjes janë transferuar tek klienti dhe klienti ka pranuar mallrat në përputhje me kontratën, kriteret e pranimit janë plotësuar ose Shoqëria ka bindjen objektive se të gjitha kriteret për pranim janë përmbytur.

Shoqëria merr në konsideratë nëse ka kushte të tjera në kontratë që janë kushte të performancës për të cilat duhet të alokohet një pjesë e çmimit të transaksionit (p.sh., garancitë, pikat e besnikërisë së klientit). Gjatë përcaktimit të çmimit të transaksionit për shitjen e mallrave, Shoqëria konsideron efektet e shumës së ndryshueshme, ekzistencën e komponentëve të rëndësishëm financiar, shumat jo-monetare dhe shumën e pagueshme për klientin (nëse ka).

Shuma korresponduese e ndryshueshme

Nëse shuma korresponduese e premtuar në një kontratë përfshin një shumë të ndryshueshme, njësi ekonomike duhet të vlerësojë shumën korresponduese për të cilën njësi ekonomike do të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave apo shërbimeve tek një klient.

Shuma korresponduese e ndryshueshme vlerësohet në fillimin e kontratës dhe kufizohet deri në masën që ka shumë mundësi që zgjidhja e mëpasshme e pasigurisë lidhur me shumën e ndryshueshme nuk do të sjellë anulim të rëndësishëm të shumës së të ardhurave të akumuluar të njohura.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Shoqëria aplikon disa zbritje kontraktuale në lidhje me faturimin e periudhës dhe objektivat kryesorë të performancës, të cilat japin një shumë korresponduese të ndryshueshme. Të ardhurat nga shitjet me zbritje njihen bazuar në çmimin e specifikuar në kontratë, neto nga zbritjet e vëllimit të vlerësuara. Përvoja e akumuluar përdoret për të vlerësuar dhe parashikuar zbritjet, duke përdorur metodën e vlerës së pritur, dhe të ardhurat njihen vetëm në masën që është shumë e mundshme që të mos ndodhë një anulim i rëndësishëm i të ardhurave të akumuluar të njohura. Një detyrim njihet për çdo zbritje që lidhet me vëllimin, i pagueshëm për klientët në lidhje me shitjet e bëra deri në fund të periudhës së raportimit, nëse nuk është faturuar ende. Zbritjet njihen plotësisht brenda periudhës.

Njohja e të ardhurave (vazhdim): Asnjë element i financimit nuk konsiderohet i pranishëm pasi shitjet bëhen me një afat pagese nga 0-30 ditë, gjë që është në përputhje me praktikën e tregut. Një llogari e arkëtueshme njihet kur mallrat dorëzohen pasi ky është momenti i caktuar në kohë kur e drejta për shumën korresponduese është e pakushtëzuar, pasi për ta konsideruar të detyrueshme për t'u paguar mjafton vetëm kalimi i kohës.

Balancat kontraktuale:

Aktive kontrate: Një aktiv kontrate është e drejta për shumën korresponduese në këmbim të mallrave apo shërbimeve të transferuara tek klienti.

Nëse Shoqëria ka performuar duke transferua shërbimet tek klienti para se klienti të paguajë shumën korresponduese ose para dates së pagesës, njihet një aktiv kontrate për shumën korresponduese të fituar që është e kushtëzuar.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare: Llogaria e arkëtueshme njihet nëse ekziston një e drejtë e shoqërisë për shumën korresponduese që nuk është e kushtëzuar (d.m.th., për t'u paguar nga klienti mjafton vetëm kalimi i kohës).

Detyrime kontrate: Një detyrim kontrate është detyrimi për të transferuar mallra ose shërbime te një klient për të cilin Shoqëria ka përfituar shumën korresponduese nga klienti. Kur klientët paguajnë shumën korresponduese para se Shoqëria të transferojë mallra ose shërbime te klienti, në momentin që bëhet pagesa njihen detyrimet e kontratës në formën e parapagimeve. Detyrimet e kontratës njihen si të ardhura kur Shoqëria dorëzon mallrat.

Detyrimet e kontratës janë të natyrës shumë operationale dhe nuk kanë një komponent të rëndësishëm financimi.

Rimbursimi i kostove për programet e marketingut. Rimbursimet për kostot e programeve të marketingut për të promovuar shitjen e produkteve të Shoqërisë, njihen si të ardhura në vitin në të cilin ndodhin shpenzimet përkatëse. Rimbursimi i kostove të shitjes njihet si e ardhur në të njëjtën kohë me shitjen e produkteve të cilave i referohet.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

3. Vlerësime të rëndësishme kontabël dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme. Drejtimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përshkruhen në paragrafin vijues, si dhe në shënimet vijuese:

- (i) shënimi 27 – Menaxhimi i riskut financiar
- (ii) shënimi 26 – Tatimi mbi fitimin

Gjatë fillimit të vitit 2020, pandemia e COVID-19 u përhap në të gjithë botën. Në Mars të vitit 2020, qeveria e Shqipërisë mori masa drastike duke pezulluar shumë aktivitete biznesi, përfshirë aktivitetet e klientëve përfundimtar të Shoqërisë për një periudhë prej 2 muajsh, me ndikim në shitje.

Shoqëria vazhdoi operacionet normale gjatë gjithë vitit pa asnjë ndërprerje. Pasojat e përhapjes së COVID-19 kanë ndikuar në zinxhirët e furnizimit dhe kërkesën për produktet kryesore të Shoqërisë dhe për këtë arsye rezultatet e saj të funksionimit janë ndikuar gjatë gjysmës së parë të vitit. Sidoqoftë, rimëkëmbja e biznesit në gjysmën e dytë të vitit, ka nxitur rezultatet e shoqërisë për vitin 2020.

Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 mbetet e paqartë në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Shoqërisë për periudhën e ardhshme. Megjithatë, aktiviteti i Shoqërisë ka vazhduar pa pezullim në 2021, dhe ka pasur një performancë relativisht të qëndrueshme në shitje dhe Shoqëria ka arritur të ketë rezultate shumë pozitive.

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale: Vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale është çështje gjykimi bazuar në eksperiencën me aktive të ngjashme. Përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin konsumohen përgjatë përdorimit. Megjithatë, faktorë të tjerë siç janë vjetërsimi teknik ose tregtar, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të lidhura me aktivet. Drejtimi vlerëson jetën e dobishme të mbetur në përputhje me kushtet teknike aktuale të aktiveve dhe periudhës së parashikuar gjatë së cilës aktivet pritet të krijojnë përfitime për Shoqërinë. Konsiderohen faktorët kryesorë të mëposhtëm: (a) përdorimi i pritshëm i aktiveve; (b) konsumimi i pritshëm fizik, i cili varet nga faktorët operacional dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimi teknik ose tregtar që vjen si rrjedhojë e ndryshimeve në kushtet e tregut.

Tatimi mbi fitimin: Drejtimi, pavarësisht pasigurisë së mjedisit shqiptar të taksave dhe legjislacionit ekzistues në fuqi beson se llogaritja e tatimit mbi të ardhurat është e përshtatshme për të gjitha vitet e hapura të taksave bazuar në vlerësimin e tij të shumë faktorëve, përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme, dhe që çdo kontroll i ardhshëm tatimor nuk do të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatet e operacioneve ose flukset e parave. Sidoqoftë, për shkak të natyrës së ligjit të tatimit mbi të ardhurat, praktikat dhe udhëzimet e ndërlydhura nuk është e mundur të sigurohet që pozicioni aktual i ligjit tatimor do të mbetet i pakontestueshëm nga autoritetet tatimore.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara

(i) Standardet e miratuara dhe efektive për periudhën aktuale

Disa ndryshime dhe interpretime zbatohen për herë të parë në vitin 2020, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë, përfshirë ndryshimin e SNK 1, i cili përshkruhet në disa detaje më poshtë. Shoqëria nuk ka miratuar herët ndonjë standard, interpretim ose ndryshim që është lëshuar, por nuk janë ende efektive.

• SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i ‘materialit’ (Ndryshimet)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 dhe janë të lejueshme për t’u zbatuar më herët. Ndryshimet sqarojnë përkufizimin e materialit dhe mënyrën se si duhet të zbatohet.

Në përkufizimin e ri thuhet se, ‘Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme që të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme mund të marrin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike të caktuar’.

Për më tepër, shpjegimet që shoqërojnë përkufizimin janë përmirësuar. Ndryshimet gjithashtu sigurojnë që përcaktimi i materialit është konsistent në të gjithë Standardet e SNRF-ve.

Drejtimi ka bërë një vlerësim të efektit të standardit dhe konsideron se standardi i ri nuk ka efekt në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Standardet, ndryshimet dhe përmirësimet e reja në vijim janë bërë efektive në 1 Janar 2020 megjithatë nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë.

- Ndryshimet në SNRF 3: Kombinimet e Biznesit,
- Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7: Reforma e Vlerësimit të Normës së Interesit,
- Ndryshimet në Kuadrin Konceptual të SNRF-ve

• IFRS 16 Qiratë – Marrëveshje qiraje të lidhura me Covid-19 (Ndryshim)

Ndryshimi zbatohet, në retrospektivë, për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 qershorit 2020. Zbatimi i mëparshëm është i lejuar, përfshirë në pasqyrat financiare ende të pa autorizuara për t’u lëshuar në 28 maj 2020. IASB ndryshoi standardin për t’u krijuar lehtësi qiramarrësve në zbatimin udhëzimeve për kontabilitetin e modifikimit të qirasë për kontratat e qirasë sipas SNRF 16, që vijnë si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë covid-19. Ndryshimi siguron një lehtësim praktik që qiramarrësi të llogarisë çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga kontrata e qirasë në lidhje me covid-19 në të njëjtën mënyrë që do të llogariste ndryshimin sipas SNRF 16, nëse ndryshimi nuk ishte një modifikim i qirasë, vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton në konsideratë të rishikuar për qiranë që është në thelb e njëjtë me, ose më pak se, shpërblimin për qiranë menjëherë para ndryshimit.
- Çdo ulje e pagesave të qirasë ndikon vetëm në pagesat që fillimisht u paguan më ose para 30 Qershorit 2021.
- Nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të qirasë.

(i) Standardet dhe Ndryshimet të lëshuara por jo ende efektive dhe të pazbatuara më herët

Standardet dhe ndryshimet e mëposhtme do të miratohen nga Shoqëria kur ato të bëhen efektive, megjithatë, këto nuk do të kenë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Miratimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

- **SNK 1: Prezantimi i Pasqyrave Financiare: Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata (Ndryshimet)** - efektive për periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2023
- **Reforma e normës së interesit që shërben si standard krahasues (benchmark) - SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 & SNRF 1 (Ndryshimet) – faza 2.**
- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjata materiale; SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me leje të zbatimit të mëparshëm. BSNK ka lëshuar ndryshime të fushës së ngushtë në Standardet e SNRF si më poshtë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** azhurnojnë një referencë në SNRF 3 në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.
- **SNK 16 Ndërtesat, Impiantet dhe Pajisjet (Ndryshimet)** ndalojnë që një Shoqëri të zbresë nga kostoja e aktiveve afatgjata materiale shumat e marra nga shitja e aktiveve të prodhuar ndërsa shoqëria është duke përgatitur aktivin për përdorimin e tij të synuar. Në vend të kësaj, një shoqëri do të njohë të ardhurat e tilla të shitjeve dhe koston e lidhur në fitim ose humbje.
- **SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara (Ndryshimet)** specifikojnë cilat kosto përfshin një shoqëri në përcaktimin e koston së përmbushjes së një kontrate për qëllimin e vlerësimit nëse një kontratë është me kushte rënduese.
- **Përmirësimet Vjetore 2018-2020** bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe Shembuj ilustrues shoqërues të SNRF 16 Qiratë

COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA SH.P.K.
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020
(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	E drejta e		Ndërtesa dhe		Makinari dhe		Mjete		Ambalazh i		Mobilje dhe		Të tjera		Punime në		Totali	
	Tokës		Instalime		pajisje		transporti		rikthyeshmë dhe		pajisje zyre				proces			
	Toka përdorimit të								pajisje ftohëse									
	tokës								pajisje ftohëse									
Kosto																		
Më 1 Janar 2019	17,623,602	62,700,000	879,797,739	1,434,111,532			50,987,064		527,892,551	142,589,544	5,766,007	1,792,485			3,123,260,524			
Shtesa	420,000	-	28,533,286	68,743,868			130,724		88,142,649	23,139,134	683,147	43,008,285			252,801,093			
Transferime	-	-	-	13,677			-		-	-	-	(13,677)			-			
Pakësime	-	-	-	(1,104,250)			(809,791)		(6,564,088)	-	-	-			(8,478,129)			
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	(1,669,620)	(43,966,017)			(12,875,675)		(28,859,189)	(22,516,522)	(105,630)	-			(109,992,653)			
Më 31 Dhjetor 2019	18,043,602	62,700,000	906,661,405	1,457,798,810			37,432,322		580,611,923	143,212,156	6,343,524	44,787,093			3,257,590,835			
Shtesa	-	-	19,190,121	76,329,928			-		103,615,688	14,257,096	29,960	4,246,710			217,669,503			
Transferime	-	-	14,394,390	10,132,560			-		(880,456)	1,240,669	(25,767,619)	-			-			
Pakësime	-	-	-	-			-		(13,011,526)	(288,857)	-	-			(1,169,313)			
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	(98,795,331)			(9,473,755)		(5,041,571)	(5,041,571)	-	-			(126,322,184)			
Më 31 Dhjetor 2020	18,043,602	62,700,000	940,245,916	1,445,465,967			27,958,567		670,335,629	153,379,493	6,373,484	23,266,184			3,347,768,842			
Amortizimi i akumuluar																		
Më 1 Janar 2019	-	(15,831,750)	(304,415,417)	(1,161,676,105)			(43,211,872)		(269,987,353)	(109,162,456)	(122,700)	-			(1,904,407,653)			
Amortizimi i vitit	-	(633,270)	(14,464,664)	(55,375,701)			(1,544,240)		(62,583,435)	(10,248,742)	-	-			(144,850,052)			
Pakësime	-	-	-	609,206			536,146		5,238,426	-	-	-			6,383,778			
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	816,066	38,823,911			11,992,595		20,822,505	17,407,434	-	-			89,862,510			
Më 31 Dhjetor 2019	-	(16,465,020)	(318,064,015)	(1,177,618,689)			(32,227,371)		(306,509,857)	(102,003,765)	(122,700)	-			(1,953,011,416)			
Amortizimi i vitit	-	(633,270)	(15,096,579)	(64,239,158)			(1,040,993)		(66,400,134)	(11,002,391)	-	-			(158,412,525)			
Pakësime	-	-	-	97,818,653			9,003,554		540,838	96,931	-	-			637,769			
Nxjerrje nga përdorimi	-	(17,098,290)	(333,160,594)	(1,144,039,195)			(24,264,810)		10,448,931	4,738,307	(122,700)	-			122,009,445			
Më 31 Dhjetor 2020	-	(17,098,290)	(333,160,594)	(1,144,039,195)			(24,264,810)		(361,920,221)	(108,170,918)	(122,700)	-			(1,988,776,726)			
Vlera kontabël																		
Më 1 Janar 2019	17,623,602	46,868,250	575,382,322	272,435,427			7,775,192		257,905,198	33,427,088	5,643,307	1,792,485			1,218,852,871			
Më 31 Dhjetor 2019	18,043,602	46,234,980	588,597,390	280,180,120			5,204,951		274,102,066	41,208,392	6,220,824	44,787,093			1,304,579,419			
Më 31 Dhjetor 2020	18,043,602	45,601,710	607,085,322	301,426,772			3,693,758		308,415,408	45,208,575	6,250,784	23,266,184			1,358,992,115			

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020
(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

E drejta e përdorimit të tokës përfaqëson kontributin në natyrë nga aksioneri, Invest P.F në kapitalin e nënshkruar. E drejta e përdorimit të tokës në të cilën ndodhet ndërtesa e Shoqërisë është e vlefshme për nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet që nga fillimi i aktivitetit të Shoqërisë. Të drejtës së përdorimit i mbaron afati në vitin 2092 dhe ka një amortizim vjetor 633,270 lekë.

Sigurimi

Nuk ka ndonjë aktiv afatgjatë material të lënë si kolateral për ndonjë kredi deri më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Amortizimi

Amortizimi shpërndahet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes si më poshtë:

	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Kosto e mallrave të shitur	90,301,214	83,874,025
Kostot e shpërndarjes	57,108,917	50,727,285
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	11,002,391	10,248,742
	<u>158,412,522</u>	<u>144,850,052</u>

6. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë

Shoqëria merr me qira ndërtesën, pajisjet dhe automjetet. Kontratat e qirasë zakonisht bëhen për periudha fikse.

	Ndërtesa	Automjete	Fasada	Totali
Vlera kontabël më 1 Janar 2019	21,653,256	101,718,320	-	123,371,576
Shtesa	-	4,328,460	16,237,973	20,566,433
Amortizimi	(5,413,308)	(62,972,722)	(345,489)	(68,731,518)
Vlera kontabël më 31 Dhjetor 2019	16,239,948	43,074,058	15,892,484	75,206,490
Shtesa	-	185,473,932	-	185,473,932
Pakësime (modifikime qiraje)	-			-
Amortizimi	(5,413,314)	(68,583,011)	(4,145,866)	(78,142,191)
Vlera kontabël më 31 Dhjetor 2020	10,826,634	159,964,978	11,746,618	182,538,231

Shoqëria ka njohur detyrime të qirasë si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Detyrime afatshkurtra të qirasë	57,683,468	40,913,207
Detyrime afatgjata të qirasë	115,882,952	23,486,722
Detyrimet totale të qirasë	<u>173,566,420</u>	<u>64,399,929</u>

Tabela e mëposhtme tregon ndryshimet në vlerën kontabël të detyrimeve të qirasë, si rezultat i: shtesave prej qirave të reja, interesave në detyrimin e qirasë, fitimeve ose humbjeve nga kursi i këmbimit dhe pagesave të qirasë:

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë (vazhdim)

	2020	2019
Vlera kontabël më 1 Janar 2020	64,399,931	113,423,430
Qira të reja (shitesa)	185,473,932	20,566,433
Interesa	5,141,913	2,649,452
Fitime/humbje nga kursi i këmbimit	2,490,560	(641,588)
Pagesat e qirasë	(83,939,915)	(71,597,796)
Vlera kontabël më 31 Dhjetor 2020	173,566,420	64,399,931

Shpenzimet që lidhen me aktivet me të drejtë përdorimi afatshkurtër (të përfshira në Koston e shitjes dhe Koston e shpërndarjes) janë lekë 6,722,441. Aktivet me të drejtë përdorimi afatshkurtër kanë të bëjnë me qiratë e karrelave dhe automjeteve që përdoren për qëllime marketingu.

7. Investimi në letra me vlerë të kapitalit

Investimi prej 23,000,000 lekë përfaqëson 2.16% (2018: 2.16%) investim të Shoqërisë në kapitalin e nënshkruar të UJI I FTOHTË TEPELENA SH.P.K., një Shoqëri e ambalazhimit të ujit në Shqipëri, Shoqëria mëmë përfundimtare e së cilës është ACIES.

Më 1 janar 2018, Shoqëria përcaktoi investimin si letër me vlerë të kapitalit në VDATGJ pasi investimi pritet të mbahet për qëllime strategjike dhe jo për qëllime fitimi nga një shitje e mëpasshme, dhe nuk ka qëllim shitje në periudhë afatshkurtër apo afatmesme. Objektivi i investimit është mbajtja e aktivitetit në periudhë afatgjatë për qëllime strategjike. Vlera kontabël më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përfaqëson vlerën e drejtë në datën e raportimit.

Investimi më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Investime në letra me vlerë të kapitalit	23,000,000	23,000,000
Totali	23,000,000	23,000,000

Gjatë vitit 2020 nuk ka patur transferime ose fitim/ humbje kumulative me kapitalin e lidhur me këtë investim.

Të ardhurat nga Dividendët e arkëtuar gjatë vitit 2020 janë 2,447,280 lekë (2019: 1,692,043 lekë).

8. Huadhënie

Gjatë vitit 2018, Shoqëria hyri në një marrëveshje huaje me ACIES me datë maturimi 31 dhjetor 2024 dhe ka një interes vjetor me një normë të luhateshme të Euribor 1V + 3.5% por jo më pak se 3.5% dhe jo më të lartë se 6%. Huaja do të disbursohet sipas skedulit në vijim:

- 1,500,000 euro brenda 31 dhjetor 2018;
- 1,000,000 euro brenda 31 dhjetor 2019;
- 1,000,000 euro brenda 31 dhjetor 2020;
- 1,000,000 euro brenda 31 dhjetor 2021;
- 500,000 euro brenda 31 dhjetor 2022.

Gjatë viteve 2018-2020, Shoqëria ka disbursuar shumën prej 2,960,000 Euro

Vlera e huasë në datën e raportimit është 366,152,000 lekë (2019: 243,540,000 lekë) dhe të ardhurat e përlllogaritura nga interes janë 11,695,093 lekë (2019: 7,420,420 lekë).

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020
(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

9. Inventarët

Inventarët në 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 mund të përmbliken si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Materiale të para	141,910,151	64,683,791
Produkte të gatshme	82,089,550	179,868,090
Zhvlerësimi për produktet e patregtueshme	(1,510,395)	(5,037,746)
Mallra	20,146,258	49,360,139
Zhvlerësimi për mallrat e patregtueshme	(451,526)	(13,160,624)
Materiale të para në tranzit	20,886,721	5,753,843
Materiale të tjera	16,137,885	12,326,276
Totali	279,208,644	293,793,769

Materiale të para në tranzit përfaqësojnë sheqerin që ndodhet në portin e Durrësit në datën e raportimit, të mbajtur në magazinën doganore deri në zhdoganim.

Materialet e tjera përfshijnë inventarët e karburanteve dhe kimikateve që përdoren në proceset e prodhimit.

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2019, Shoqëria rriti inventarët në produktet e gatshme, në përputhje me investimet e planifikuara dhe parashikimin e shitjeve për periudhën T4 2019-T1 2020. Ky vendim i referohet investimit të planifikuar në sallën e re të shurupit. Investimi nisi në nëntor 2019 dhe u finalizua në Prill 2020.

Tabela e mëposhtme tregon lëvizjet në zërin “Zhvlerësimi për inventarin e patregtueshem”:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Vlera kontabël më 1 janar 2020	(18,198,370)	-
Fshirje inventari	18,198,370	-
Provizjon për inventarin e vjetruar – Produkt i Gatshëm	(1,510,395)	(5,037,746)
Provizjon për inventarin e vjetruar – Mallra	(451,526)	(13,160,624)
Vlera kontabël më 31 dhjetor 2020	(1,961,921)	(18,198,370)

10. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përfaqësojnë kryesisht të arkëtueshmet nga shitjet e produkteve dhe mallrave.

Në fund të vitit shoqëria fshiu llogaritë e arkëtueshme që ishin të pamundura për t’u arkëtuar në vlerën 2,013,712 lekë, të cilat i referohen shumës së pa mbledhur nga një distributor me të cilin shoqëria ka një çështje të hapur ligjore që nga viti 2010. Shoqëria ka vlerësuar humbjen e pritshme (HP) për llogaritë e arkëtueshme tregtare në datën e raportimit, dhe arriti në përfundimin që nuk është materiale dhe për rrjedhojë nuk ka njohur zhvlerësim të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat e saj financiare:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Nga shitja e produkteve	3,229,004	5,531,341
Nga shitja e mallrave të tjera dhe ofrimi i shërbimeve	1,168,639	5,724,075
Totali	4,397,643	11,255,416

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020
(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

11. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Uji i Ftohte Tepelene Shpk	19,944,376	18,355,335
SIBEG Srl	4,409,022	4,194,489
Crilu Shpk	10,396,921	-
Totali	<u>34,750,319</u>	<u>22,549,824</u>

Shoqëria ka vlerësuar humbjen e pritshme (HP) për llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura në datën e raportimit, dhe arriti në përfundimin që nuk është materiale dhe për rrjedhojë nuk ka njohur zhvlerësim të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat e saj financiare.

12. Aktive të tjera

Aktivet e tjera në 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë përmbledhur më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Paradhënie për furnitorët	5,903,367	12,035,410
Shpenzimet e parapaguara	14,817,860	10,865,262
Interesa të përlllogaritur	11,909,312	7,525,535
Të ardhurat e pa-faturuara	2,059,552	29,107,170
Të tjera	3,859,098	5,678,605
Totali	<u>38,951,850</u>	<u>66,492,326</u>

13. Depozitat me afat

Depozitat me afat më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Depozitat me afat	282,348,000	395,310,000
Totali	<u>282,348,000</u>	<u>395,310,000</u>

Që nga 31 dhjetor 2020, depozitat me afat të Shoqërisë përbëjnë një depozitë prej 30,000 mijë lekë (2019: 30,000 mijë lekë) që mbart normë interesi vjetore prej 1,4% dhe depozita prej 252,348 mijë lekë, ekuivalente me euro 2.04 milion (2019: ekuivalent me euro prej 3 milion) e cila ka normë vjetore interesi prej 0,01%. Kjo e fundit, është vendosur si garanci bankare nga Shoqëria në emër të ACIES Srl (Shoqëria mëmë) në Intesa San Paolo Bank. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj humbjes së kredisë nuk konsiderohet material.

14. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare;

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në banka rezidente	495,705,365	433,819,103
Mjete monetare në arkë	852,685	1,494,164
Depozita me afat maturimi më pak se 3 muaj	-	-
Totali	<u>496,558,050</u>	<u>435,313,267</u>

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të normës së interesit dhe analiza e ndjeshmërisë për aktivet dhe detyrimet financiare janë përfshirë në shënimin 27.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare – 31 Dhjetor 2020

(Shumat në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

15. Kapitali i paguar

Kapitali i paguar i Shoqësë më 31 dhjetor 2020 është 1,493,040,000 lekë (2019: 1,493,040,000 lekë) Struktura e kapitalit të paguar përbëhet nga 1 kuotë prej 1,115,151,576 lekë, 1 kuotë prej 338,173,560 lekë dhe 1 kuotë prej 39,714,864 lekë. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, interesat e pjesëmarrjes së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar përfaqësohen nga mbajtësit e kuotave që zotërojnë vetëm një kuotë. Kuota përfaqëson pjesëmarrjen e mbajtësit të kuotës në kapitalin e shoqërisë dhe secila kuotë mbart të drejtat e votës në proporcion me pjesën e kapitalit të përfaqësuar nga kuota.

Më poshtë paraqitet struktura e kapitalit të Shoqërisë:

	31 Dhjetor 2020			31 Dhjetor 2019		
	Numri i kuotave	Pjesëmarrja në %	Lekë	Numri i kuotave	Pjesëmarrja në %	Lekë
SIBEG	1.00	74.69	1,115,151,576	1.00	74.69	1,115,151,576
TCCEC	1.00	22.65	338,173,560	1.00	22.65	338,173,560
Invest P.F.	1.00	2.66	39,714,864	1.00	2.66	39,714,864
	3.00	100	1,493,040,000	3.00	100	1,493,040,000

Dividendët

Ortakët zotërojnë të drejtën e përfitimit të dividendit të deklaruar dhe të drejtën e votës në mbledhjet e përgjithshme të Shoqërisë, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit përfaqësuar nga kuota. Të gjitha të drejtat e votimit në përpjesëtim me pjesën e kapitalit përfaqësuar nga kuota renditen në mënyrë të barabartë lidhur me aktivet e mbetura të Shoqërisë.

Më 15 Prill 2020, mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve miratoi shpërndarjen e mëposhtme të fitimit për vitin fiskal 2019:

